

Ndreqje gabimi

Në ligjin nr.10125, datë 11.5.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave, Alpha Bank A.E. e Deutsche Bank A.G., dega e Londrës, si rregullues, institucioneve financiare, të listuara si huadhënësit fillestarë dhe Alpha Bank A.E., dega e Londrës, si agjent, për financimin e shpenzimeve kapitale për vitin 2009, në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillimin dhe integrimin e Shqipërisë”, botuar në **Fletoren Zyrtare nr.66, 14 maj 2009**, në tekstin e marrëveshjes, përmbajtja e Seksionit që fillon me fjalët:

“Shërbimi i huasë 250 m euro për Republikën e Shqipërisë - Kushtet Tregtare” dhe përfundon me fjalët “3. Kjo letër rregullohet nga dhe do të interpretohet në përputhje me ligjin anglez”, **zëvendësohet me tekstin si më poshtë:**

Letër Ndryshuese (Tarifë kontributi)

1. Kjo letër është shtesë e marrëveshjes së garancisë së datës 5 maj 2009 (Marrëveshja) e lidhur ndërmjet (i) Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të Financave) si huamarrës (**Huamarrësi**), (ii) Alpha Bank A.E dhe Deutsche Bank AG, Dega e Londrës si rregullues (në këtë kapacitet **Rregulluesit** ose **Rregulluesi** do të thotë njërin prej tyre), (iii) bankave dhe institucioneve financiare të përmendura në Shtojcën 1 të saj si huadhënës (së bashku **Huadhënësit**), dhe (iv) Alpha Bank A.E, Dega e Londrës si agjenti (në këtë cilësi **Agjenti**), në pajtim me të cilën Huamarrësit kanë rënë dakord (*ndër të tjera*) t’i ofrojnë Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve që gjenden atje, shumën principale deri në dy qind e pesëdhjetë milion Euro (250 000 000 Euro). Kjo letër përfundohet me qëllim rregullimin e gabimit në llogaritje që gjendet në dispozitën 11.1 të Marrëveshjes dhe ajo përbën një ndryshim në Marrëveshje dhe si Huamarrësi ashtu edhe Agjenti e përcaktojnë këtë letër si Dokument Financiar.

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe ose nëse nuk përkufizohen ndryshe këtu, kanë të njëjtin kuptim siç përdoren në këtë letër.

3. Huamarrësi dhe Agjenti (në emër të të gjithë Palëve Financiare) bien dakord që, me efekt nga data e kësaj letre, klauzola 11.1 (*Tarifa e Përkushtimit*) të Marrëveshjes ndryshohet (si më poshtë) dhe ri-shprehet me tekstin e mëposhtëm:

(11.1 Tarifa e Kontributit

Huamarrësi i pague Agjentit (për llogari të secilit Huadhënës) një tarifë të llogaritur me normën e

(a) Përqindjes Përkatëse në vit mbi Përkushtimin e Disponueshëm të Huadhënësit sipas Instrumentit A për periudhën nga data që bie dhjetë (10) Ditë Pune nga data e kësaj Marrëveshjeje deri në ditën e fundit të Periudhës së Disponueshmërisë që zbatohet për Instrumentin A; dhe

(b) Përqindjes Përkatëse në vit mbi Përkushtimin e Disponueshëm të Huadhënësit sipas Instrumentit B për periudhën nga data që bie pesë(5) Ditë Pune nga data e kësaj Marrëveshjeje deri në ditën e fundit të Periudhës së Disponueshmërisë që zbatohet për Instrumentin B; dhe

Për qëllimet e kësaj Dispozite 11.1, përqindje përkatëse do të thotë çdo moment përkatës:

(i) nëse marzhi i zbatueshëm në këtë moment është 9.65% në vit, 7.2375% në vit; ose

(ii) nëse marzhi i zbatueshëm në këtë moment është 10.65% në vit, 7.9875% në vit.”

4. Huamarrësi dhe Agjenti bien dakord dhe njohin që (a) norma e tarifës së përkushtimit e shprehur në Marrëveshje (d.m.th, para ndryshimit të saj nga kjo letër) ishte shkruar gabimisht 0.75% në vit dhe futja e kësaj norme në Marrëveshje përbën thjesht një gabim në llogaritje nga të gjithë Palët dhe (b) norma e tarifës së përkushtimit siç shprehet në dispozitën e ndryshuar 11.1 (*Tarifa e Përkushtimit*) të marrëveshjes nëpërmjet paragrafit 3 të kësaj letre janë normat e sakta për të cilat është rënë dakord prerë dhe pa mëdyshje kurdoherë nga të gjitha Palët, po ashtu edhe ndërmjet Rregulluesve dhe Huamarrësit në letërën autorizuese në lidhje me Instrumentet (duke qenë 75% të marzhit të zbatueshëm të rënë dakord).

5. Me efekt nga data e kësaj letre, referencat në Marrëveshje dhe në Dokumentet e tjerë Financiarë në Marrëveshje konsiderohen të përfshijnë Marrëveshjen të ndryshuar dhe të plotësuar nga kjo letër.

6. Me përjashtim të ndryshimeve nga kjo letër me qëllimin e vetëm të ndryshimit të gabimit në llogaritje të përmendur më sipër, të gjitha termat dhe kushtet e Marrëveshjes dhe Dokumentet e tjerë Financiarë mbeten të pandryshuar dhe në fuqi dhe efekt të plotë.

7. Mosrespektimi nga ju i termave të kësaj letre përbën Ngjarje të Qenies në Vonesë sipas Marrëveshjes.

8. Dispozitat e klauzolës 28 (*Njoftimet*) dhe klauzolës 36 (*Zbatimi*) të Marrëveshjes përfshihen në këtë Marrëveshje sikur të parashikoheshin tërësisht në këtë Marrëveshje dhe sikur referencat në ato dispozita të “kësaj Marrëveshjeje” janë referenca në këtë letër.

9. Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për sa më sipër duke kundërfirmuar dhe kthyer tek ne kopjen e bashkangjitur të kësaj letre.

10. Kjo letër (duke përfshirë çdo detyrim jo-kontraktor në lidhje me këtë letër) rregullohen nga dhe interpretohen në pajtim me ligjin anglez.

Sinqerisht i Juaji

(*firmë*)

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të:

ALPHA BANK AE Dega e Londrës

Si Agjent

Datë: 5 maj 2009